



REPUBLIKA E SHQIPERISË
SH.A UJËSJELLËS KANALIZIME LEZHË

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Nr _____ Prot

Lezhë,më: 26/10/2020

Për: ILVA ELEKTRIK,

Adresa: Tiranë, Muhamet Gjollësja, 32/1/1, Tiranë.

Procedura e prokurimit: “ Kërkesë Për Propozime” , me mjete elektronike.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Blerje Elektropompa për Ujin e Pijshëm.

Numri i Referencës së Procedurës së Prokurimit : REF-72676-09-23-2020

Fondi limit : 5.583.656 (pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tremijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë) leke pa Tvsh ,

Burimi i Financimit: nga buxheti i shtetit.

Kohezgjatja e kontratës : brënda 12 (dymbëdhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës (nëse zbatohet):

Data e zhvillimit të procedurës: 12.10.2020 ora 10.00

Buletini i Njoftimeve Publike; Nr. 77, Datë 28 shtator 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1. A.K.M ALBANIAN INVESTMENT GROUP shpk** **NIPT: L72230026K**
Me vlerë ekonomike 4.471.000 (katërmilion e katërqind e shtatëdhjetë e njëmijë) lekë pa tvsh
- 2. ILVA ELEKTRIK shpk** **NIPT: K01607005N**
Me vlerë ekonomike 5.475.000 (pesë milion e katërqind e shtatëdhjetë e pesëmijë) lekë pa tvsh
- 3. KLOSI – R COMPANY shpk** **NIPT: L72120030I**
Me vlerë ekonomike 3.490.000 (tremilion e katërqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa tvsh
- 4. VASAA shpk** **NIPT: J62903470T**
Me vlerë ekonomike 3.993.730 (tremilion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tremijë e shtatëqind e Tridhjetë) lekë pa tvsh.

Jane skualifikuar ofertuesit e mëposhtem ;

1. A.K.M ALBANIAN INVESTMENT GROUP shpk NIPT: L72230026K

Autoriteti kontraktor Ujësjeselles Kanalizime Lezhë sh.a. ne procedure e prokurimit me object “Blerje elektropompa” per ujin e pijshem me procedure Kerkese per propozime me mjete elektronike me fond limit : 5,583,656 leke pa TVSH ne specifikimet teknike ,preventivi te dokumenteve standarte te tenderit për sasinë e mallrave që kërkon Autoriteti Kontraktor nder te tjera ne nr.rendor 10 (Dhjete) ka kerkuar ekzaktesisht e konkretisht si me poshte:

Shih prventivin dhe specifikimet teknike te Autoritetit Kontraktor , Numri rendor 10 i preventivit; elektropompe siperfaqesore vertikale $Q= 16.2 \text{ m}^3 / \text{ore}$, $H= 170 \text{ m}$ fuqia orjentuese 15 KW / $Y/\Delta 660/380 \text{ V} / 50 \text{ Hz}$, **cope 4 (Kater)**.

Nga ana juaj Operatori ekonomik A.K.M ALBANIAN INVESTMENT GROUP sh.p.k ne formularin e ofertes ekonomike tek numri rendor 10 I ofertës eshte paraqitur ekzaktesisht dhe konkretisht si me poshte:

Shih ofertën tuaj bashkëlidhur Nr. rendor 10 i ofertës (shenuar me të kuqe nga ana jonë) elektropompe siperfaqesore vertikale $Q= 16.2 \text{ m}^3 / \text{ore}$, $H= 170 \text{ m}$ fuqia orjentuese 15 KW / $Y/\Delta 660/380 \text{ V} / 50 \text{ Hz}$ ku keni ofertuar **copë 1 (një)** elektropompë në kundërshtim me sasinë e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor UK Lezhë Sh.a i cili ka kërkuar **cope 4 (katër)** elektropompë.

Pra Operatori ekonomik A.K.M ALBANIAN INVESTMENT GROUP sh.p.k nuk e ka paraqitur formularin e ofertes ekonomike për sasinë e mallrave siç eshte kerkuar ne dokumentet standarte te tenderit tek specifikimet teknike pra te preventivi i autoritetit kontraktor Ujësjeselles Kanalizime Lezhe sh.a.

Kjo do te thote se operatori ekonomik A.K.M ALBANIAN INVESTMENT GROUP sh.p.k ne oferten e tij ekonomike për sasinë e mallrave (elektropompa) ne numrin rendor 10 te ofertës (shenuar me te kuqe nga ana jone) tek sasia e mallrave (elektropompave) ka paraqitur vetëm një elektropompë, ndërsa Autoriteti Kontraktor ka kërkuar 4 (katër) elektropompa, pra operatori ekonomik ka parqitur 3 elektropompa me pak seç ka kërkuar Autoriteti Kontraktor, me karakteristika; elektropompe siperfaqesore vertikale $Q= 16.2 \text{ m}^3 / \text{ore}$, $H= 170 \text{ m}$ fuqia orjentuese 15 KW / $Y/\Delta 660/380 \text{ V} / 50 \text{ Hz}$ në kunërshtim kjo me dokumentat standarte të tenderit të preventivit dhe specifikimet teknike të Autoritetit Kontraktor.

2. Autoriteti kontraktor Ujësjeselles Kanalizime sh.a. Lezhe gjate verifikimit te ofertave ekonomike te operatoreve ekonomik ka verifikuar dhe konstatuar se operatori ekonomik A.K.M ALBANIAN INVESTMENT GROUP sh.p.k ne proceduren e prokurimit me objekt “Blerje elektropompa” per ujin e pijshem UKL me procedure Kerkese per propozime me mjete elektronike me fond limit : 5,583,656 leke pa TVSH ka kryer gabime te genesishme dhe thelbesore ne perllogaritet e ofertes ekonomike per çmime per njesi dhe vlerat perkatese e konkretisht:

Operatori ekonomik A.K.M ALBANIAN INVESTMENT GROUP sh.p.k ka paraqitur oferten ekonomike me vlere 4,471,000 leke pa TVSH.

Autoriteti kontraktor Ujësjeselles Kanalizime sh.a. Lezhe gjate verifikimeve te ofertave ekonomike ka konstatuar se Operatori ekonomik A.K.M ALBANIAN INVESTMENT GROUP sh.p.k ka bere gabim ne perllogaritetjen e çmimeve per njesi dhe vlere ne Shumen 465,000 (Katerqind e gjashtedhjete e pesemije) leke pa TVSH .

Kjo do të thote se Operatori Ekonomik ne oferten e tij ekonomike ka kryer gabime thelbësore përkundrejt vlerës ekonomike të 4,471,000 leke pa tvsh, ndersa ne baze te llogaritjeve reale, kjo ofertë e paraqitur duhet te ishte 4,936,000 (katermilion e nenteqind e tridhjete e gjashtemije) leke pa TVSH. Diferenca e gabimit ndermjet vleres totale te ofertes ekonomike te paraqitur nga ana juaj dhe vleres reale te perlllogaritur nga ana jone ne oferten tuaj eshte ne vleren 465,000 (katerqind e gjashtedhjete e pesemije) leke pa TVSH . Pra oferta e paraqitur nga Operatori juaj ekonomik A.K.M ALBANIAN INVESTMENT GROUP sh.p.k është në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik si dhe dokumentat standarte të tenderit, te preventivit dhe te specifikimeve teknike te Autoritetit Kontraktor UK Lezhë Sh.a.

3. Në ofertën, dokumentacionin e parqitur, konkretisht çertifikata ISO 9001:2015 dhe objekti i saj nuk perputhet me objektin e prokuruar ,eshte patur parasysh dhe konstatuar se ISO 9001: 2015 e kompanise AQSCERT e paraqitur ne kete prokurim nuk perputhen me objektin e prokuruar sepse skedat dhe specifikimet teknike si dhe katalogjet e pompave te paraqitur jane te nje kompanie tjeter prodhuese e konkretisht MARLY SPECIALISTS IN RISING LIQUIDS .

Operatori Ekonomik A.K.M ALBANIAN INVESTMENT GROUP sh.p.k me dokumentacionin teknik te prezentuar ne kete prokurim nuk provohet lidhja ndermjet ISO 9001:2015 me katalogjet ,me deklaratat e konformitetit te EU , skedave e specifikimeve teknike si dhe katalogjeve te pompave zhytесе dhe pompave siperfaqesore vertikale dhe horizontale a ne kete prokurim, e konkretisht te MARLY SPECIALISTS IN RISING LIQUIDS .

4. Operatori ekonomik A.K.M ALBANIAN INVESTMENT GROUP sh.p.k nuk ka paraqitur skemat e lidhjes elektrike të elektropompave, të asnjëres prej elektropompave që kërkohen në prokurim, siç është kërkuar në specifikimet teknike të Autoritetit Kontraktor. Ndërsa mungojnë per disa mallra te kerkuara, elektropompave, katalogjet dhe dokumentacioni teknik, skedat teknike dhe specifikimet teknike të cilat nuk tregojne dhe prezantojne katalogje dhe specifikime teknike te pompave zhytесе dhe centrifugale horizontale dhe vertikale te paraqitura per prokurim nga ana jone.

5. Pompat siperfaqesore horizontale ,vertikale, pompat zhytесе si dhe dokumentacioni teknik , specifikimet teknike dhe katalogjet e paraqitura nga ana juaj ne kete prokurim konstatohet se jane te pergjithshme, pra katalogjet dhe specifikimet teknike nuk paraqiten ne menyre specifike për çdo elektropompë siç janë kerkuar nga Autoriteti kontraktor ne kete prokurim.

2. KLOSI – R COMPANY shpk

NIPT: L72120030I

Autoriteti kontraktor Ujësjetles Kanalizime Lezhë sh.a. ne proceduren e prokurimit me object “Blerje elektropompa” per ujin e pijshem me procedure Kerkese per propozime me mjete elektronike me fond limit : 5,583,656 leke pa TVSH ne specifikimet teknike ,preventivi te dokumenteve standarte te tenderit për sasinë e mallrave që kërkon Autoriteti Kontraktor , nder te tjera ne nr.rendor 10 të preventivit (Dhjetе) ka kerkuar ekzaktesisht e konkretisht si me poshte:

Shi prventivit dhe specifikimet teknike të Autoritetit Kontraktor Numër rendor 10 i preventivit; elektropompe siperfaqesore vertikale $Q= 16.2 \text{ m}^3 /\text{ore}$, $H= 170 \text{ m}$ fuqia orjentuese 15 KW / $Y/\Delta 660/380 \text{ V} /50 \text{ Hz}$, **cope 4 (kater) .**

Nga ana juaj Operatori ekonomik KLOSI – R – COMPANY SHPK ne formularin e ofertes ekonomike tek numri rendor 10 I ofertës eshte paraqitur ekzaktisht dhe konkretisht si me poshte:

Shih ofertën tuaj tuaj bashkëlidhur; Nr.rendor 10 i ofertës (shenuar me te kuqe nga ana jone) elektropompe siperfaqesore vertikale $Q= 16.2 \text{ m}^3 / \text{ore}$, $H= 170 \text{ m}$ fuqia orjentuese $15 \text{ KW} / Y/\Delta 660/380 \text{ V} / 50 \text{ Hz}$, ju keni ofertuar cope 1 (nje) elektropompë, në kundërshtim me sasinë e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor i cili ka kërkuar cope 4 (katër) elektropompë.

Pra Operatori ekonomik KLOSI – R – COMPANY SHPK nuk e ka paraqitur formularin e ofertes ekonomike për sasinë e mallrave siç eshte kerkuar ne dokumentet standarte te tenderit tek specifikimet teknike pra te preventivit te autoritetit kontraktor Ujesjelles Kanalizime Lezhe sh.a.

Kjo do te thote se operatori ekonomik KLOSI – R – COMPANY SHPK ne oferten e tij ekonomike për sasinë e mallrave (elektropompa) ne numrin rendor 10 te ofertës (shenuar me te kuqe nga ana jone) tek sasia e mallrave, elektropompë ka paraqitur vetë 1 (një) elektropompë, ndërsa Autoriteti Kontraktor ka kërkuar 4 (katë) elektropompa , pra operatori ekonomik ka paraqitur 3 (tre) elektropompa më pak seç ka kërkuar Autoriteti Kontraktor, me karakteristika; elektropompe siperfaqesore vertikale $Q= 16.2 \text{ m}^3 / \text{ore}$, $H= 170 \text{ m}$ fuqia orjentuese $15 \text{ KW} / Y/\Delta 660/380 \text{ V} / 50 \text{ Hz}$, në kundërshtim kjo me dokumentat standarte të tenderit, të preventivit dhe specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor.

2. Autoriteti kontraktor Ujesjelles Kanalizime sh.a. Lezhe gjate verifikimit te ofertave ekonomike te operatoreve ekonomik ka verifikuar dhe konstatuar se operatori ekonomik KLOSI – R – COMPANY SHPK ne proceduren e prokurimit me objekt “Blerje elektropompa” per ujin e pijshem UKL me procedure Kerkese per propozime me mjete elektronike me fond limit : 5,583,656 leke pa TVSH **ka kryer gabime te qenesishme dhe thelbesore ne perllogaritjet e ofertes ekonomike per çmime per njesi dhe vlerat perkatese e konkretisht:**

Operatori ekonomik KLOSI – R – COMPANY SHPK ka paraqitur oferten ekonomike me vlere 3,490,000 leke pa TVSH.

Autoriteti kontraktor Ujesjelles Kanalizime sh.a. Lezhe gjate verifikimeve te ofertave ekonomike ka konstatuar se Operatori ekonomik KLOSI – R – COMPANY SHPK ka bere gabime të mëdha ne perllogaritjen e çmimeve per njesi dhe vlera ne Shumen 500,000 (peseqind mije) leke pa TVSH .

Kjo do te thote se Operatori Ekonomik KLOSI – R – COMPANY SHPK ne oferten e tij ekonomike ka kryer gabime thelbesore përkundrejt vlerës ekonomike të 3,490,000 (Tremilion e katerqind e nentedhjetemije) leke pa tvsh, ndersa ne baze te llogaritjeve reale kjo ofertë e paraqitur duhet te ishte 3,990,000 (Tremilion e nenteqind e nentedhjetemije) leke pa TVSH. Diferenca e gabimit ndermjet vleres totale te ofertes ekonomike te paraqitur nga ana juaj dhe vleres reale te perllogaritur nga ana jone ne oferten tuaj eshte ne vleren 500,000 (Peseqindmije) leke pa TVSH, pra oferta e paraqitur nga ana juaj, operatori ekonomik KLOSI – R – COMPANY SHPK është në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit public si dhe dokumentat standarte te tenderit., të prventivit dhe specifikimeve teknike te Autoritetit Kontraktor UK Lezhë Sh.a.

3. Operatori ekonomik KLOSI – R – COMPANY SHPK në ofertën, dokumentacionin e paraqitur, konkretisht çertiifikata ISO 9001:2015 dhe objekti i saj nuk perputhet me objektin e prokuruar , eshte patur parasysh dhe konstatuar se ISO 9001: 2015 e kompanise LMS ASSESSMENTS e paraqitur ne kete prokurim nuk perputhen me objektin e prokuruar.

4. Operatori ekonomik **KLOSI – R – COMPANY SHPK** nuk ka paraqitur asnjë nga; Skedat, specifikimet teknike si dhe katalogjet e pompave te kerkuara nga Autoriteti kontraktor.
5. Operatori ekonomik **KLOSI – R – COMPANY SHPK** nuk ka paraqitur asnjë Dokumentacion teknik,katalogjet , ndërsa skemat e lidhjes elektrike mungojnë per te gjitha mallrat e kerkuara, elektropompat.
6. Pompat siperfaqesore horizontale ,vertikale si dhe pompat zhytuese dhe dokumentacioni teknik ,specifikimet teknike dhe katalogjet nuk jane paraqitur ne kete prokurim nga Operatori ekonomik .

3. VASAA shpk

NIPT: J62903470T

Autoriteti Kontraktor Ujësjetës Kanalizime Lezhë Sh.a bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik Nr. 9643, datë 20.11.2006 “ Për prokurimin publik” i ndryshuar, nëVkm Nr. 914, datë , datë 29.12.2014 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, I NDRYSHUAR, ka konstatuar se oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik VASAA Shpk në bazë të formulës përcaktuar nga rregullat e prokurimit public ka rezultuar se oferta juaj është anomalisht e ulët, në zbatim te dispozitave ligjore për këtë qellim Autoriteti Kontraktor UK Lezhë Sh.a ju ka dërguar ‘Kërkesë per shpjegime për elemente të veçantë të ofertës ” me ane te shkresës Nr. 618 Prot, Datë 14.10.2020.

Operatori ekonomik VASAA shpk ka dërguar me datë 16.10.2020 shkresën ku argumentuar se: Për shkak të situates së krijuar nga COVID 19 nuk mund të realizojë proceduren.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se Operatori ekonomik **ILVA ELEKTRIK**, **NIPT: K01607005N** *adresa*; Tiranë, Muhamet Gjollës, 32/1/1, Tiranë. , se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 5.475.000 (pesëmilion e katërqind e shatëdhjetë e pesëmijë) lekë pa tvsh /pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Ujësjetës Kanalizime Lezhë Sh.a**, me adresë; Lagjja "Nene Tereza", Rruga Bajram Curri, Ndertese 2-Kateshe ne zonen kadastrale nr.8632, numri i pasurise 1/130, Lezhë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej (nuk ka ofertues të dytë të kualifikuar) , siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë ; 16/10/2020

Ankesa: ka ose jo : **Jo nuk ka pasur**

(nëse ka)

Drejtuesi i Autoritetit Kontraktor

Ing. Zef MAÇI